



M.Sc. Lirije Bytyqi-Beqiri & Gani Gajraku

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT
Raport hulumtimi

Prishtinë, 2015

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Autorë:

M.Sc. Lirije Bytyqi- Beqiri
Gani Gajraku

Redaktor:

M.Sc. Ismet Potera

Recensentë:

M.Sc. Shpend Bajrami
Prof. Bahtir Shabani

Ekipi hulumtues:

Gani Gajraku
M.Sc. Lirije Bytyqi-Beqiri

Korrektore gjuhësor: Mirjeta Gashi

Përgatitja teknike:

M.Sc. Lirije Bytyqi-Beqiri

PËRMBAJTJA

Abstrakti.....	4
Abstractt.....	6
PEDAGOGU I SHKOLLËS PJESE E SHËRBIMIT PEDAGOGJIK- PSIKOLOGJIK NË SHKOLLA.....	10
METODOLOGJIA.....	15
Objekti dhe rëndësia e hulumtimit.....	16
Lloji i hulumtimit.....	17
Popullata dhe mostra.....	17
Struktura e mostrës.....	19
Instrumentet e hulumtimit.....	21
Procedura e mbledhjes së të dhënave.....	22
Analiza e të dhënave.....	23
REZULTATET E HULUMTIMIT.....	24
PLANIFIKIMI I PUNËS EDUKATIVE-ARSIMORE.....	26
Ndihma e pedagogut të shkollës në planifikimin e mësimeve.....	28
GJENDJA AKTUALE E PLANIFIKIMIT TË MËSIMIT.....	30
Angazhimet e pedagogut në shkollë.....	42
PËRKRAHJA E MËSIMDHËNËSVE NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT.....	49
Ndihma rreth planifikimit të mësimit.....	49
Sfidat gjatë planifikimit.....	53
Kontributi i pedagogut në hartimin e planeve mësimore.....	60
Përfundime.....	85
Rekomandime.....	88
REFERENCA DHE BIBLIOGRAFI.....	90

Abstrakti

Hulumtimin “Roli i pedagogut të shkollës në planifikimin e mësimit” e kemi bërë me qëllim që të shohim se cili është roli i pedagogut të shkollës në planifikimin e mësimit. Për të parë se cili është roli i tij në këtë drejtim, kemi shqyrtuar bazën ligjore; Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Udhëzimet Administrative, në të cilat përcaktohen kriteret për zgjedhjen e pedagogut si bashkëpunëtor profesional në institucionet edukative-arsimore, detyrat dhe përgjegjësitë ndaj institucionit si dhe funksionimin e shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë.

Hulumtimin e kemi realizuar përmes intervistave dhe pyetësorëve.

Nga të dhënat që kemi mbledhur, është konstatuar se në vitin shkollor 2014/2015, në 12 komunat e përfshira në hulumtim, kanë qenë të inkuadruar 24 pedagogë në shkolla. Nga hulumtimi rezulton se pedagogu i shkollës merr pjesë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe realizimin e punës edukative-arsimore. Mësimdhënësit, me rastin e planifikimit, kërkojnë ndihmë nga pedagogu i shkollës. Ndihma më e shpeshtë, që mësimdhënësit e kërkojnë në këtë drejtim ka të bëjë me përgatitjen e planifikimeve vjetore të mësimit, planifikimeve mujore dhe planifikimin ditë-mësimor. Gjithashtu, i përkrah dhe i ndihmon mësimdhënësit në hartimin e rezultateve mësimore, që do të arrihen me nxënës brenda vitit, muajit dhe orës mësimore; në përmbajtjen dhe metodologjinë e përzgjedhur, në planifikimin e aktiviteteve mësimore dhe në përgatitjet për orë mësimore.

Ai kontrollon planifikimet e mësimeve të përgatitura nga

Raport hulumtimi

mësimdhënësit, i analizon ato dhe nëse është e nevojshme u jep sugjerime dhe udhëzime të nevojshme.

Mësimdhënësit, gjatë planifikimit të mësimit, hasin në sfida të ndryshme. Për tejkalimin e tyre, pedagogun e shohin si personin kyç.

Pedagogu i shkollës, përmes monitorimit, përcjell në mënyrë sistematike planifikimin e mësimave dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara nga mësimdhënësit. Monitorimin, mësimdhënësit e shohin si mbështetje dhe mundësi e mirë për avancim, sepse vërejtjet, sugjerimet dhe këshillat që ofrohen nga pedagogu, u ndihmojnë mësimdhënësve në planifikimin, organizimin dhe realizimin e mësimit.

Fjalë kyçe: Bashkëpunim, Pedagog, mësimdhënësi, Plan dhe Program Zyrtar, planifikim, proces edukativ-arsimor, shkollë.

Abstrackt

The research "The role of the school pedagogues in lesson planning ", I made it in order to see what the role of the school pedagogue is in lesson planning. To see what its role is in this regard, we have reviewed the legal basis; Law on Education and Administrative Instructions, in which it is determined the criteria for the selection of professional associate professor in educational institutions, duties and responsibilities to the institution and functioning of pedagogical-psychological service in school. The research we conducted was through interviews and questionnaires.

From the data we have collected, it was found that in the academic year 2014/2015, in 12 municipalities included in the survey, were involved 24 pedagogues from the schools.

The research has shown that pedagogues participate in all school matters related to the planning and implementation of educational work. Teachers, when planning, seek help from the school pedagogue. The most common assistance that teachers require in this regard relates to the preparation of annual learning plans, monthly plans and day-curriculum planning. Also, the pedagogue supports and assists teachers in developing learning outcomes that need to be reached with the students during the year, month and class; content and methodology selected in the planning of learning activities and preparations for hours. He controls the planning of lessons prepared by the teachers, analyzes them and, if necessary, gives them suggestions and guidance that are needed. Teachers, during the planning

Raport huluntimi

for the teaching, face different challenges. To overcome them, the pedagogue is seen as the key person to overcome those challenges. The Pedagogue of the school, through monitoring, systematically follows the lessons for planning and implementation of activities planned by teachers. As well as monitoring, teachers see the pedagogue as support and opportunity for advancement, for comments, suggestions and advice provided by the lecturer, assist teachers in planning, organization and implementation of learning.

Keywords: collaboration, pedagogue, teacher, Plan and Program Officer, planning, educational process, school.

Hyrje

Viteve të fundit, është diskutuar dhe është shkruar shpesh për nevojën për pedagogë dhe për shërbimin pedagogjik, për detyrat dhe kompetencat që duhet t'i kenë.

Përkushtim i veçantë rreth kësaj problematike është bërë edhe nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë. Për këtë qëllim, në vitin 2013 MASHT ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr.26/2013 Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukative-arsimore parauniversitare, në të cilin përcaktohen kriteret për zgjedhjen e pedagogut si bashkëpunëtor profesional, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij për institucionin. Me Udhëzimin Administrativ 34/2014 rregullohet funksioni i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë, përkatësisht puna e pedagogut dhe e psikologut të shkollës.

Qëllimi i hulumtimit ishte të konstatohet dhe vlerësohet roli i pedagogut të shkollës në planifikimin e mësimin, sa dhe si i ndihmon mësimdhënësit gjatë procesit të planifikimit, si e përcjell punën e tyre?

Hulumtimi është realizuar me anë të intervistave dhe

Raport hulumtimi

pyetësorëve të përgatitur për pedagogë dhe mësime dhënë. Intervistat janë realizuar me pedagogë, ndërsa me mësime dhënë hulumtimi është realizuar me anë të pyetësorëve.

**PEDAGOGU I SHKOLLËS BËNË PJESË E SHËRBIMIT
PEDAGOGJIK-PSIKOLOGJIK NË SHKOLLA**

Pedagogu i shkollës bënë pjesë në stafin profesional. Me Ligjin për Arsimin Parauniversitar, pedagogët përfshihen në personelin profesional jomësimdhënës. “Personat e kualifikuar sipas standardeve të specifikuara në një akt nënligjor mund të zgjidhen nga komuna në institucionet arsimore për të ofruar shërbime profesionale, përfshirë: kujdesin mjekësor, mbështetjen pedagogjike-psikologjike, si dhe punë këshilluese dhe sociale”. (Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 37, pika 1, faqe 25).

Ndërsa në bazë të Udhëzimit Administrativ MASHT nr.34, Funkzioni i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla, pedagogët emërtohen si bashkëpunëtorë profesional që parashihen në kuadër të shërbimit pedagogjik-psikologjik. Sipas këtij udhëzimi, pedagog i shkollës është personi i cili ka përfunduar studimet e nivelit Master në Degën e Pedagogjisë të Fakultetit Filozofik, përkatësisht, Fakultetin e Edukimit, studimet katërvjeçare në Degën e Pedagogjisë, apo siç është

Raport hulumtimi

rregulluar me UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional (Udhëzimi Administrativ MASHT, nr.34, Funkzioni i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla, faqe 2).

Detyrat e punës së pedagogut të shkollës orientohen në organizimin e punës drejt realizimit të detyrave të planifikuara në Planin zhvillimor të shkollës dhe të Drejtorisë Komunale të Arsimit, në harmoni me dokumentet pedagogjike të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe konform planifikimit dhe realizimit të punës së gjithëmbarshme në shkollë.

Detyrat e punës së pedagogut të shkollës:

- Harton planin individual të punës në përputhje me specifikat e shkollës në të cilën punon;
- Bashkërendon punët me drejtorin e shkollës në funksion të realizimit të rezultateve të pritura konform planit zhvillimor të shkollës;
- Merr pjesë në mbledhjet me prindër, këshill të arsimtarëve, aktiveve profesionale duke dhënë këshilla dhe sugjerime në funksion të mbarëvajtjes së përgjithshme të punës së shkollës;

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

- Mban takime individuale me prindër, arsimtar, nxënës dhe faktor tjerë që kanë ndikim direkt ose indirekt në procesin e punës edukative dhe arsimore;
- Përcjell vlerësimin e nxënësve, kohën e vlerësimit dhe mënyrën e tij si dhe vijueshmërinë e nxënësve në shkollë;
- Zhvillon vizita nëpër orë mësimore dhe përgatitjen e raporteve për orët e hospituara duke dhënë rekomandime, këshilla dhe sugjerime në funksion të realizimit të rezultateve të pritura konform njësisë mësimore dhe lëndës së caktuar mësimore;
- Punon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Mban përgjegjësinë kryesore në zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Bashkëpunon në hartimin e planit të punës për mësimdhënësit e lëndëve dhe klasave të ndryshme dhe raporton për aktivitetet e zhvilluara;
- Zhvillon dhe përkrah sistemin gjithëpërfshirës që siguron qasje të barabartë në arsim për të gjithë pa dallim;
- Kryen punë tjera të caktuara nga udhëheqësi konform detyrave të punës.

Raport hulumtimi

Ky përshkrim i detyrave është marrë nga pedagogët e shkollave dhe nga dokumentet që përcaktojnë veprimtarinë e tyre. Edhe pse formulimi i detyrave dallon, shumica e pedagogëve të intervistuar, i përshkruanin detyrat e tyre në atë mënyrë.

Pedagogu i shkollës merr pjesë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe realizimin e punës edukative-arsimore në shkollë. “Pedagogu i shkollës është ekspert i cili me punën e tij i kontribuon lehtësimit të problemeve të ndryshme që shfaqen në shkollë si tek nxënësit, mësime dhënësit, prindërit apo të gjithë akterët tjerë shkollor si dhe kontribuon në ngritjen e cilësisë së veprimtarisë edukative-arsimore”(Udhëzimi Administrativ MASHT nr. 34/2014 Funksionimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla, faqe 4-5)

Ai bashkëpunon me mësime dhënësit në hartimin e planit të punës, për mësime dhënësit e lëndëve dhe të klasave të ndryshme dhe raporton për aktivitetet e zhvilluara. Pedagogu, poashtu organizon hulumtime në shkollë për çështje të ndryshme edukative dhe arsimore, përcjell të arriturat shkencore profesionale nga lëmi i planifikimit të punës mësimore dhe për këto të arritura i informon

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

mësimdhënësit me qëllim që këto të arritura shkencore t'i bëjë pjesë të planeve mësimore.

Pedagogu si mbështetës dhe koordinator, ndihmon dhe mbikëqyrë planifikimin dhe organizimin edhe të formave tjera të punës që ndihmojnë procesin e mësimdhënies dhe nxënies, si: punën e diferencuar, punën plotësuese, punën e shtuar, mësimin zgjedhor, format tjera të punës me nxënës në shkollë, aktivitetet arsimore që zhvillohen në nivel të shkollës dhe të komunës, vizitat, ekskursionet dhe aktivitetet të tjera edukative.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Hulumtimi është realizuar gjatë vitit shkollor 2014/2015, në 12 komuna: Prishtinë, Drenas, Malishevë, Skenderaj, Mitrovicë, Ferizaj, Prizren, Suharekë, Gjakovë, Junik, Podujevë dhe Obiliq.

Qëllimi i hulumtimit ishte të hulumtohet dhe vlerësohet roli i pedagogut në planifikimin e mësimit dhe ndihma që u ofron mësimdhënësve gjatë procesit të planifikimit.

Bazuar në qëllimin e hulumtimit janë parashtruar edhe hipotezat e hulumtimit. Supozojmë se:

- Pedagogu i shkollës ka rol të rëndësishëm në planifikimin e mësimit;
- Pedagogu i shkollës ndihmon mësimdhënësit e shkollës gjatë procesit të planifikimit;
- Pedagogu i shkollës në mënyrë sistematike përcjell punën e mësimdhënësve në shkollë.

Nga hipotezat për hulumtimin janë nxjerrur edhe pyetjet hulumtuese. Pyetja kryesore e hulumtimit është:

- Cili është roli i pedagogut të shkollës në planifikimin e mësimit?

Ndërsa, si ndihmë për të arritur deri te qëllimi, kemi

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

parashtruar edhe dy pyetje hulumtuese, të cilat do të na ndihmonin marrjen e informacioneve shtesë për përkrahjen që pedagogu u ofron mësimdhënësve.

- A i ndihmon pedagogu i shkollës mësimdhënësit gjatë procesit të planifikimit?

- Si e përcjell pedagogu i shkollës punën e mësimdhënësve?

Për mbledhjen e të dhënave, kemi hartuar instrumentet e nevojshme për hulumtim (intervista dhe pyetësorë), ndërsa analizën e të dhënave e kemi bërë përmes programit SPSS.

Objekti dhe rëndësia e hulumtimit

Objekt i hulumtimit është angazhimi/ndihma e pedagogut që ofron gjatë planifikimit të mësimit. Gjatë kohës së hulumtimit në disa shkolla të Republikës së Kosovës, kishte 24 pedagogë në nivel shkolle.

Raport hulumtimi

Lloji i hulumtimit

Hulumtimi ka dy qasje, sasiore dhe cilësore. Janë zgjedhur dy qasje, sepse kemi dashur të ofrojmë të dhëna për numrin e pedagogëve, që në kohën e hulumtimit ishin në rolin e pedagogut të shkollës duke përshkruar opinionet e pedagogëve dhe mësimeve për:

- rolin që ka pedagogu në planifikimin e mësimit,
- ndihmën që pedagogu i shkollës iu ofron mësimeve gjatë procesit të planifikimit të mësimit, si dhe,
- përcjelljen e vazhdueshme të punës së mësimeve.

Popullata dhe mostra

Popullata e këtij hulumtimi ishte dy shtresore, heterogjene. Popullatën e përbëjnë pedagogët dhe mësimeve e Arsimit Parauniversitar. Në hulumtim janë përfshirë vetëm shkollat ku ka pedagog shkolle, prandaj rezultatet e hulumtimit janë specifike vetëm për shkollat ku është shtri hulumtimi.

Mostër e hulumtimit kanë qenë:

- 24 pedagogë në nivel shkolle dhe
- 167 mësimeve.

Kriteret për zgjedhjen e mostrës


Për të përcaktuar mostrën, paraprakisht kishim caktuar dy kritere. Në hulumtim do të merrnin pjesë personat që aktualisht ishin:

- Pedagog shkolle,
- Mësimdhënës në shkollën ku ka pedagog shkolle.

Kemi përzgjedhur shkollat ku ka pedagog, sepse gjatë pilotimit të instrumentit, kemi parë se mësimdhënësit e shkollave ku nuk kishte pedagog, nuk ishin të informuar për rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e pedagogut në shkollë.

Struktura e mostrës

Hulumtimi është shtri në 12 komuna, gjegjësisht në 24 shkolla. Në figurat e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për respondentët e përfshirë në hulumtim.



Grafiku 1. Struktura gjinore e respondentëve

Grafiku 1 tregon përfaqësimin e respondentëve sipas gjinisë. Në përfaqësimin e respondentëve të përfshirë në hulumtim nuk kishte ndonjë dallim të theksuar sa i përket gjinisë, megjithatë në përqindje shumë të vogël shohim se dominon gjinia femërore.

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

MOSHA	Pedagog shkollë		Mësimdhënës	
	Nr	%	Nr	%
21-30	3	12.5	24	14.4
31-40	4	16.6	51	30.5
41-50	7	29.16	37	22.2
51-60	9	37.5	42	25.1
Mbi 60	1	4.16	13	7.79
Gjithsej	24	100	167	100

Tabela 1. Përfaqësimi sipas moshës

Në tabelë shohim se pedagogët e përfshirë në hulumtim ishin të moshave të ndryshme, prej tyre, 12.5% ishin të moshës 21-30 vjeç, 16.6% ishin të moshës 31-40 vjeç, 29.16% ishin të moshës 41-50 vjeç, 37.5% ishin të moshës 51-60 vjeç, ndërsa 4.16% ishin të moshës mbi 60 vjeç. Nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim 14.4% ishin të moshës 21-30 vjeç, 30.5% ishin të moshës 31-40 vjeç, 22.2% ishin të moshës 41-50 vjeç, 25.1% ishin të moshës 51-60 vjeç ndërsa 7.79% ishin të moshës mbi 60 vjeç.

Numri më i madh i pedagogëve i përkiste moshës 51-60 vjeç, ndërsa numri i madh i mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim i përkiste moshës 31-40 vjeç.

Nga të dhënat e përgjithshme të responentëve mund të

Raport hulumtimi

konkludojmë se, numri më i madh i respondentëve të përfshirë në hulumtim i përkasin moshës 31-40 vjeçare.

Instrumentet e hulumtimit

Për realizimin e hulumtimit kemi përdorur dy lloje të instrumenteve:

1. Intervista
2. Pyetëtori

Me pedagogë kemi zhvilluar intervista, ndërsa nga mësime të ndryshme të dhënat i kemi mbledhur përmes pyetësorëve.

Intervistat me pedagog shkolle përmbante të dhëna personale për pedagogun/en, të dhëna për shkollën si dhe të dhëna që lidhen me hulumtimin.

Pyetësorët janë zhvilluar me mësime të ndryshme. Pyetëtori përmbante pyetje për të dhënat personale të mësime të ndryshme, si: Gjinia, moshë, përkatësia shkollore dhe përvoja e punës, si dhe të dhëna lidhur me hulumtimin.

Shumica e pyetjeve ishin të kombinuara, në të cilat kërkohet që, përveç përgjigjes, të jepet edhe mendimi i mësime të ndryshme. Kishte pyetje të hapura në të cilat

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

mësimdhënësit, kishin mundësinë të shprehnin lirshëm mendimet e tyre si dhe pyetje të mbyllura, me përgjigje të sugjeruara (të tipit Likert).

Procedura e mbledhjes së të dhënave

Të dhënat i kemi mbledhur me anë të pyetësorëve dhe intervistave. Gjatë mbledhjes së të dhënave kemi pasur parasysh edhe aspektin etik, si: respektimin e ligjeve, rregulloreve, respektimin e institucioneve dhe individëve të cilët janë përfshirë në studim.

Fillimisht janë hartuar instrumentet e hulumtimit dhe është bërë pilotimi i tyre. Pas plotësimeve të nevojshme të instrumenteve, kemi kontaktuar me SMIA, ku kemi siguruar të dhënat për numrin e pedagogëve. Pastaj, kemi kontaktuar me Drejtoritë Komunale të Arsimit, dhe kemi siguruar kontaktet me pedagogët, ku bashkërisht me pedagogun kemi caktuar orarin e përshtatshëm për vizitë/hulumtim. Kemi zhvilluar intervistën me pedagogen/pedagogun e shkollës dhe kemi shpërndarë pyetësorët për 10 mësimdhënësit. Administrimi i pyetësorëve dhe intervistat janë zhvilluar në të njëjtën kohë. Për këtë ka qenë e nevojshme që në të njëjtën kohë,

Raport hulumtimi

në të njëjtën shkollë, të pranishëm të jenë dy hulumtues, ku njëri ka zhvilluar intervistën me pedagog, ndërsa tjetri ka administruar pyetësorët me mësimdhënës.

Analiza e të dhënave

Analiza i të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve është bërë përmes programit SPSS (Statistical Package for the Social Sciences - Pakoja Statistike për Shkencat Shoqërore). Pyetësorët janë koduar dhe pastaj të dhënat janë futur në program.

Paraprakisht përgjigjet i kemi kategorizuar dhe kemi krijuar modele për analizën e të dhënave sipas kategorive. Të dhënat e mbledhura përmes intervistave janë analizuar përmes metodës së analizës.

Për këtë kemi përgatitur tabela të veçanta për të bërë regjistrimin dhe kategorizimin e përgjigjeve të dhëna.

Pas kategorizimit, përgjigjet i kemi koduar dhe i kemi analizuar përmes programit SPSS.

REZULTATET E HULUMTIMIT

Rezultatet e studimit përfshijnë të gjitha të dhënat e mbledhura, duke përfshirë të dhënat e pedagogëve dhe të dhënat e mbledhura nga mësimdhënësit.

Të dhënat në vazhdim pasqyrojnë perceptimet e 24 pedagogëve dhe 167 mësimdhënësve që kanë marrë pjesë në hulumtim.

Në kohën e hulumtimit ishin 24 pedagogë shkolle, në 12 komuna.

Nr.	Komuna	Numri i pedagogëve
1	Prishtinë	2
2	Drenas	8
3	Podujevë	1
4	Skenderaj	1
5	Malishevë	2
6	Obiliq	1
7	Suharekë	1
8	Ferizaj	2
9	Junik	1
10	Mitrovicë	2
11	Gjakovë	1
12	Prizren	2
Gjithsej		24

Tabela 2. Numri i pedagogëve në shkolla

Raport hulumtimi

Tabela 2 pasqyron numrin e pedagogëve. Siç është cekur më lartë, gjatë kohës së hulumtimit në 35.29% të komunave të Republikës së Kosovës, ka pedagog shkolle.

Nëse e krahasojmë me numrin e shkollave kjo shifër del të jetë shumë e ulët. Komuna e Drenasit ka numrin më të madh të pedagogëve në shkolla. Pedagogët janë inkuadruar në punë, në bazë të numrit të nxënësve. Në shkollat e mesme të larta, ku numri i nxënësve është i madh, është i inkuadruar pedagogu, ndërsa në shkollat fillore, të mesme të ulëta, ku numri i nxënësve është më i vogël 1 pedagog shkolle, punon në dy ose tri shkolla, duke ndarë kështu ditë të veçanta pune për secilën shkollë.

Këtë e mundëson Udhëzimi Administrativ nr. 26/2013 Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukative-arsimore parauniversitare me të cilin parashihet që një shërbyes profesional, punësohet në institucionin edukativ-arsimor, nëse institucioni ka mbi 1000 nxënës/fëmijë. Shërbyesit profesional, mund të punësohen edhe në disa institucione edukative-arsimore, të cilat bashkë e arrijnë numrin mbi 1000 nxënës/fëmijë (Për këtë shih udhëzimin, Neni 3, pika 1 dhe 2).

PLANIFIKIMI I PUNËS EDUKATIVE-ARSIMORE

Për mbarëvajtjen e punës edukative-arsimore, në shkollë nevojiten një disa planifikime. Pedagogu i shkollës merr pjesë aktive në planifikimin e punës edukative-arsimore.

Përveç planifikimeve vjetore të punës së tij, të cilat janë të obligueshme, ai merr pjesë dhe u ndihmon mësimdhënësve në planifikimet mësimore.

Pedagogu i shkollës ka rol të rëndësishëm në planifikimin dhe organizimin e punës edukativo-arsimore në shkollë. Kjo është paraparë edhe me Udhëzimin Administrativ nr. 34/2014, ku në bazë të këtij udhëzimi pedagogu i shkollës kryen këto punë:

1. Planifikon dhe organizon punën edukative-arsimore.
2. Mbështet hartimin dhe zbatimin e planit zhvillimor të shkollës.
3. Koordinon punën e aktiveve profesionale, planprogramin e mësimdhënësve.
4. Përkrah klubet e nxënësve, këshillat e prindërve dhe organet apo këshillat tjerë të shkollës.
5. Merr pjesë në hulumtimin e nevojave të shkollës, në hartimin dhe zbatimin e projekteve shkollore.

6. Përcjell dhe inkurajon futjen e risive dhe praktikave të mira pedagogjike (Udhëzimi Administrativ MASHT nr. 34/2014 Funksionimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla, faqe 5).

Pedagogu i shkollës merr pjesë aktive në planifikimin e mësimit dhe aktiviteteve tjera në shkollë. Është pjesë e planifikimit shkollor, si në planifikimin vjetor të shkollës, por edhe në hartimin e Planit zhvillimor të shkollës.

Nga 24 pedagogë të shkollave sa ishin pjesëmarrës në hulumtimin tonë, 50.1 % e pedagogëve marrin pjesë në hartimin e Planit zhvillimor të shkollës, 37.5% kanë informacion për planin zhvillimor por nuk kanë marrë pjesë në hartimin e tij, respektivisht, 12.5% prej tyre nuk kanë informacione për Planin zhvillimor të shkollës. Vlen të theksohet se pedagogët të cilët deklaruan se nuk kanë informacione për Planin zhvillimor të shkollës, ishin pedagogë të ri, të cilët kishin vetëm disa muaj që ushtronin detyrën e tyre si pedagog shkolle.

Në planifikimin vjetor të shkollës marrin pjesë të gjithë pedagogët, respektivisht 100% e pedagogëve të shkollave. Të gjithë pedagogët e shkollave kanë Plan vjetor të punës së pedagogut, planet mujore dhe planet tjera të veprimit.

Ndihma e pedagogut të shkollës në planifikimin e mësimëve

Nga të dhënat e mbledhura në terren del se, të gjithë pedagogët e shkollave, e hartojnë Planin dhe programin vjetor të punës së pedagogut, planet mujore, planet e bashkëpunimit me institucione tjera arsimore dhe OJQ. Ndhimjnë në hartimin e planeve të punës së aktiveve profesionale, planet vjetore të Këshillave të klasave, planifikimet e takimeve me prindër, hartimin e planeve dhe programeve mësimore, etj. Edhe në aspektin e planifikimit dallon puna e pedagogut nga shkolla në shkollë.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se pedagogu i shkollës, ndihmon shumë në planifikimin e mësimëve. Ndhimja/përkrahja që u ofron mësimdhënësve është e shumëllojshme:

- 50.8% e pedagogëve ndihmojnë në planifikimin e mësimëve, duke ndihmuar në planifikimet vjetore dhe planifikimet mujore mësimore;
- 20.7% e pedagogëve ndihmojnë mësimdhënësit në hartimin e rezultateve mësimore;

Raport hulumtimi

- 10.7% e pedagogëve përveç planifikimeve vjetore dhe mujore, ndihmojnë mësimdhënësit në planifikimin e aktiviteteve me prindër dhe planifikimet e Këshillave të klasave;
- 4.2% ndihmojnë edhe në planifikimin e punës së Aktiveve profesionale;
- 4.0% e pedagogëve ndihmojnë mësimdhënësit në planifikimin e punës së aktiviteteve të lira;
- 3.7% e pedagogëve bëjnë edhe përshkrimin e detyrave për kujdestar të klasave, prindër dhe mësimdhënës;
- 2.5% prej tyre, për punën individuale me nxënës nuk bëjnë plane të detajuara, por varësisht prej specifikave i përshtaten punës me fëmijë;
- 2.2% e pedagogëve i ndihmojnë mësimdhënësit të bëjnë shkoqitjen e planit javor nga plani mujor;
- 1.2% bëjnë edhe planin për dorëzimin e planifikimeve mujore të mësimdhënësve.

Pedagogët përveç që hartojnë planet vjetore të punës, ndihmojnë mësimdhënësit në hartimin e planeve vjetore, mujore, ditore, përgatitjet për orë mësimore, planin për punën vullnetare, etj.

GJENDJA AKTUALE E PLANIFIKIMIT TË MËSIMIT

Planifikimi i mësimit është veprimtari komplekse, ndërsa plani mësimor paraqet bazën teorike, ku parashihen elementet kryesore për mbarëvajtjen e mësimit. Për të parë se cila është gjendja e planifikimit të mësimit në shkollat tona, gjatë intervistave me pedagogë, kemi marrë opinione edhe për llojet e planifikimeve mësimore. Planifikimet mësimore, sipas pedagogëve, bëhen me qëllim të realizimit sa më të suksesshëm të aktiviteteve dhe arritjes së rezultateve mësimore. Për këtë qëllim, mësimitdhënësit bëjnë planifikime vjetore, mujore dhe planifikime/përgatitje për orë mësimore.

Gjatë procesit të planifikimit mësimor, mësimitdhënësit fokusohen në njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, të cilat duhet t'i zotërojnë nxënësit gjatë një periudhe kohore për të cilën planifikohet.

Mësimitdhënësi, përveç që ka njohuri për përmbajtjen mësimore që do të mësohet, i njih mirë edhe nxënësit me të cilët punon si dhe kushtet dhe mundësitë e shkollës.

Sipas pedagogëve, për një planifikim sa më të suksesshëm, mësimitdhënësi duhet ta njoh mirë Kurrikulin, në mënyrë

që planifikimin ta bëjë duke u bazuar në Planet dhe Programet mësimore Zyrtare. Pedagogu, u ndihmon mesimdhënësve në këtë drejtim, duke i nxitur ata, që planifikimin e mësimit ta fokusojnë në zotërimin e kompetencave që janë të përfaqësuara në Kurrikulën Bërthamë. Kurrikula është dokument i cili ofron mbështetje për shkollën, mbështetë “nxënësit në zhvillimin gradual të tyre, në zhvillimin e kompetencave për arsimim tërëjetësor dhe në integrimin e lehtë shoqëror, duke i përgatitur që të ballafaqohen me sfida të jetës (Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Prishtinë, 2012, faqe 10).

Po ashtu, Kurrikula Bërthamë, mbështet mesimdhënësit në planifikimin dhe realizimin e suksesshëm të punës me nxënës - aktivitet mësimore në klasë dhe jashtë klase, në përgjigjet e pyetjeve: Përse dhe për Ç’qëllim duhet të mësojnë nxënësit: Çfarë, Kur, Sa dhe Si do të mësojnë nxënësit, si dhe Çfarë, Kur dhe Si të vlerësohen arritjet e nxënësve - realizimi dhe efektiviteti i aktiviteteve mësimore. (Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

arsimin fillor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Prishtinë, 2012, faqe 10)

Duke pasur parasysh se ky dokument u dedikohet dhe u shërben mësimdhënësve, nxënësve dhe të gjithë aktorëve të përfshirë në arsim, është e qartë edhe rëndësia që ka për shkollën. Por, a janë informuar shkollat për përmbajtjen e këtij dokumenti që është i obligueshëm për shkollën?

Nga të dhënat e marra nga pedagogët dhe mësimdhënësit, del se jo të gjitha shkollat janë të informuara për Kurrikulin e Ri.


Nga pedagogët e intervistuar, kemi nxjerr këto të dhëna :

- 20.8% pohojnë se shkolla nuk është e informuar për Kurrikulën Bërthamë, ndërsa
- 79.2% e pedagogëve të shkollave pohojnë se shkolla është e informuar.

Ndërsa nga mësimdhënësit e përfshirë në hulumtim, kemi këto të dhëna:

- 70% prej tyre pohojnë se kanë informacione për Kurrikulin, ndërsa
- 25% pohojnë se nuk kanë informacione për të.

Raport hulumtimi



Grafiku 2. Krahasimi mes përgjigjeve të dhëna nga pedagogët dhe mësimdhënësit

Në grafikun 2 shohim se nuk ka dallime të dukshme mes përgjigjeve të dhëna nga pedagogët dhe mësimdhënësit.

Pedagogu u sugjeron mësimdhënësve që planifikimin mësimor ta mbështesin në Plane dhe Programe mësimore Zyrtare, ndërsa tekstet shkollore t'i shfrytëzojnë si një nga burimet e shumta, përmes të cilave arrihet deri te realizimi i aktiviteteve dhe rezultateve mësimore. Planet dhe Programet Zyrtare, janë hartuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë gjatë viteve 2003-2005. Për arsye të pamundësisë për t'u siguruar ekzemplarë të mjaftueshëm, për secilin mësimdhënë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për shkollat ka siguruar nga një ekzemplar të Planeve dhe Programeve

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

Zyrtare, për të cilat, zakonisht, kujdeset drejtori ose pedagogu i shkollës dhe mban evidencë për marrjen apo kthimin e tyre nga mësimdhënësit.

Që nga viti 2003, përkatësisht 2005, këto plane do të duhej të ishin në dispozicion të mësimdhënësve, dhe shkollat të pajiseshin me to. Por: *A janë pajisur shkollat me Planet dhe Programet Zyrtare?*

Sipas pedagogëve, shumica e shkollave janë të pajisura me Plane dhe Programe Zyrtare. Ato plane janë në shkolla, në dispozicion të mësimdhënësve dhe ruhen në zyre të drejtorit ose të pedagogut të i shkollës.

Se sa i shfrytëzojnë mësimdhënësit ato, sipas tyre varet prej punës së pedagogut dhe drejtorit të shkollës, sa ata i nxisin mësimdhënësit t'i përdorin ato.


Edhe pse të gjitha shkollat do të duhej të ishin të pajisura me Plane dhe Programe Zyrtare, nga të dhënat që morëm nga pedagogët e shkollave, del se, ka shkolla në të cilat mungojnë Planet dhe Programet Zyrtare, nëse jo të gjitha mungojnë disa prej tyre.

Nga numri i përgjithshëm i pedagogëve të intervistuar, del se:

- 60.9 % i kanë të gjitha Planet dhe Programet Zyrtare;

Raport hulumtimi

- 26% e pedagogëve në nivel shkolle, pohojnë se shkollat e tyre janë të pajisura me Planet dhe Programet Zyrtare, por mungojnë për disa klasë apo lëndë;
- 8.7% pohojnë se mungon plani dhe programi për klasën e katërtë, 4.3 % u mungon plani dhe programi për klasën e pestë, 4.3% deklarojnë se mungon plani dhe programi për klasën e nëntë dhe 8.7% pohojnë se mungojnë planet dhe programet për lëndët profesionale;
- 13,1% e pedagogëve të shkollave pohojnë se në shkollën e tyre mungojnë të gjitha Planet dhe Programet Zyrtare të hartuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, pra nuk i kanë fare.



Grafiku 3. A posedon shkolla Planet dhe Programet Zyrtare- të dhënat sipas pedagogëve

Nga të dhënat e cekura në grafikun 3, shohim se numri më i madh i shkollave janë të pajisura me Planet dhe

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

Programet Zyrtare, por nuk është e vogël edhe përqindja e shkollave të cilat nuk i kanë në dispozicion Planet dhe Programet Zyrtare.

Duke pasur parasysh se numri i shkollave të cilat nuk posedojnë Planet dhe Programet Zyrtare, nuk është i vogël, shtrohet pyetja: *Sa janë të informuar mësimmhënësit për to?*

Nga përgjigjet që morëm nga mësimmhënësit që ishin pjesë e hulumtimit tonë rezulton se:

- 63.6% prej tyre, kanë informata për Planet dhe Programet Zyrtare të hartuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë;
- 34.4% pohojnë se nuk janë të informuar;
- 2% kanë pak informacione, që kryesisht, i marrin nga kolegët e tyre.

Por: Sa janë këto plane dhe programe mësimore në shërbim të mësimmhënësve në shkollat të cilat i posedojnë ato?

Edhe pse Planet dhe Programet Zyrtare, janë në shkollë, ka raste kur ato nuk janë në shërbim të mësimmhënësve. Nga të dhënat e mbledhura rezulton se:

- 83.3 % e pedagogëve të shkollave pohojnë se ato janë

Raport hulumtimi

në shërbim të të gjithë mësimdhënësve, dhe ato i shfrytëzojnë rregullisht;


➤ 8.3% e pedagogëve pohojnë se Planet dhe Programet , janë në shërbim vetëm për aktivet profesionale, pasi ekziston vetëm një kopje, ku, kryetari i aktivitet profesional është përgjegjës për to;

➤ Planet dhe Programet Zyrtare, janë vazhdimisht në shërbim të mësimdhënësve dhe ato qarkullojnë tek mësimdhënës, këtë e pohojnë 4.2% e pedagogëve;

➤ 4.2 % e pedagogëve pohojnë se Planet dhe Programet Zyrtare edhe pse një kopje gjendet në shkollë, ato nuk janë në shërbim të mësimdhënësve, dhe sipas tyre mësimdhënësit gjejnë alternativa të tjera të shfrytëzimit të tyre, disa i bëjnë kopje, disa i shfrytëzojnë kopjet elektronike, etj.

Nga hulumtimi me mësimdhënës del se, 74.2% e mësimdhënësve Planet dhe Programet Zyrtare, i kanë në shërbim dhe punojnë me to, 24.5 % prej tyre nuk i përdorin fare Planet dhe Programet Zyrtare, ndërsa 1.3% e mësimdhënësve pohojnë se herë pas here i konsultojnë ato por nuk i kanë vazhdimisht në shërbim ato plane.

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT



Grafiku 4. A janë në shërbim të mësimdhënësve Planet dhe Programet Zyrtare

Në grafikun 4 shohim se mes përgjigjeve të dhëna nga pedagogët dhe mësimdhënësit nuk ka dallime të mëdha, afërsisht të njëjta në të tri përgjigjet ku dallimet janë prej 8%-20%. Dallime më të dukshme kemi te përgjigjja se Planet dhe Programet Zyrtare, nuk janë në shërbim të mësimdhënësve. Dallimi në mes të përgjigjeve të dhëna, është rreth 20%. Ka raste kur Planet dhe Programet Zyrtare, ndodhen në shkollë, por ato nuk janë në shërbim të mësimdhënësve.

Edhe pse numri më i madh i pedagogëve dhe mësimdhënësve pohojnë se Planet dhe Programet Zyrtare, janë në shërbim të mësimdhënësve, prapë dilema qëndron në mënyrën se si dhe sa ata i shfrytëzojnë ato.

Raport hulumtimi

Shumica e mësimeve pohojnë se për përgatitjen e planifikimeve mësimore mbështeten në Planet dhe Programet Zyrtare. Mësimeve, i marrin dhe shërbehen me to në periudha të ndryshme gjatë vitit shkollor.

Nga pedagogët të cilët pohojnë se Planet dhe Programet Zyrtare, janë në shërbim të mësimeve, kemi përgjigje të ndryshme për kohën se kur ata i marrin ato plane.

➤ 54.1% e pedagogëve pohojnë se Planet dhe Programet Zyrtare, të hartuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, mësimeve i marrin para shtatorit, në fillim të vitit shkollor.

➤ 20.8 % e pedagogëve pohojnë se Planet dhe Programet Zyrtare, mësimeve i marrin në fund të vitit shkollor.

➤ 4.2 % e pedagogëve pohojnë se i marrin në shtator,

➤ 4.2 % prej tyre sipas nevojës i marrin dhe i kthejnë gjatë vitit shkollor.

Nga këto të dhëna, shohim se numri më i madh i mësimeve Planet dhe Programet Zyrtare, i marrin nga pedagogu i shkollës para shtatorit, pra në fillim të vitit

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

shkollor, në periudhën kur ata e fillojnë punën rreth planifikimit vjetor dhe përgatitjen e planit dhe programit për muajin shtator, por, nuk është i vogël edhe numri i mësimitdhënësve të cilët Planet dhe Programet Zyrtare i marrin në fund të vitit shkollor, pra planet për klasën/vitin shkollor në vijim.

Edhe mundësitë e kthimit të Planeve dhe Programeve Zyrtare nga mësimitdhënësit, janë të shumta. Numri më i madh i mësimitdhënësve i marrin kopje dhe nuk kanë nevojë t'i kthejnë fare, ndërsa ata që i marrin versionet origjinale për arsye se shkolla

nuk ka ekzemplarë të mjaftueshëm, duhet t'i kthejnë dhe koha kur ata duhet t'i kthejnë nuk është e njëjtë.

Zakonisht, planifikimi i mësimit bëhet nga mësimitdhënësi i lëndës apo mësimitdhënësi i klasës. Sipas pedagogëve, është e rëndësishme që planifikimi i mësimit të bëhet bashkërisht, në bashkëpunim me mësimitdhënësit e tjerë, me qëllim që të mundësohet korrelacioni mes lëndëve, meqë, integrimi i lëndëve është edhe synim i Kurrikulës Bërthamë.

Përveç planifikimeve vjetore dhe mujore, në shumicën e shkollave të përfshira në hulumtim mësimitdhënësit, i bëjnë

Raport hulumtimi

edhe parapërgatitjet për orën mësimore. Mungesa e një plani të detajuar për rrjedhën e orës mësimore, e bën mësimin jo atraktiv, të mërzitshëm dhe gjithnjë të njëjtë. Duke qenë se mësimi organizohet me një grup të nxënësve dhe brenda grupit kemi nxënës të aftësive të ndryshme, kërkohet që mësimdhënësi të bëjë një përgatitje serioze të planifikimit të mëimit, duke filluar nga analiza për përbërjen e klasës, pastaj vendosjen e qëllimeve, përmbajtjeve, zgjedhjen e formave të përshtatshme mësimore, vlerësimin e punës së kryer etj.

Angazhimet e pedagogut në shkollë

Puna/angazhimi i pedagogut të shkollës është i shumanshëm, si në: planifikimin, organizimin dhe realizimin e punës edukativo-arsimore, po ashtu në punën me mësimdhënës, organet profesionale, me menaxherin e shkollës, me nxënës, punën me prindër, punë hulumtuese, informim dhe orientim profesional të nxënësve, etj.

Në pyetjen e parashtruar pedagogëve se: *Cilat janë angazhimet e juaja si pedagog shkolle?*- kemi marrë këto përgjigje:


- Përkrahin dhe ndihmojnë mësimdhënësit rreth planifikimit të mësimt;
- Kontrollonin planet dhe programet vjetore, mujore dhe përgatitjet ditore të mësimdhënësve;
- Bëjnë punë këshilluese me mësimdhënës, nxënës, prindër;
- Monitorojnë mësimdhënësit në orë mësimore;
- Angazhohen me nxënës problematikë;
- Bëjnë përgatitjet e dosjeve të mësimdhënësve;
- Regjistrojnë e nxënësit në klasën e parë;
- Sistemojnë nxënësit në klasat e para;

Raport hulumtimi

- Bëjnë punë me fëmijë me nevoja të veçanta,
- Bëjnë hulumtime për procesin e mësimdhënies dhe nxënies;
- Mbajnë ligjërata për zhvillim profesional si dhe për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies me mësimdhënës, prindër dhe nxënës;
- Përcjellin dhe ndihmojnë punën e aktiviteteve të ndryshme që bëhen në shkollë dhe jashtë saj;
- Bëjnë analizën e suksesit të nxënësve;
- Marrin pjesë në të gjitha takimet që mbahen për interes të shkollës;
- Bashkëpunojnë me udhëheqjen e shkollës për organizime të ndryshme, me mësimdhënës dhe nxënës dhe rininë shkollore.

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

- Përkrahje, ndihmë mësime të ndihmësve në planifikimin e mësimit
- Kontrollon planet dhe programet vjetore, mujore, përgatitjet ditore
- Ligjërata, këshilla, punë me nxënës me sjellje jo të rregullta
- Konsultime me mësime të ndihmësve
- Përkrahje, ndihmë mësime të ndihmësve në planifikimin e mësimit, punë këshilluese me prind



Grafiku 5. Angazhimet e pedagogut të shkollës

Në grafikun 5 shohim se angazhimet e mëdha të pedagogut të shkollës kanë të bëjnë me përkrahjen, ndihmën e mësime të ndihmësve në planifikimin e mësimit, ku:

- 25% e pedagogëve pohojnë se angazhimin më të madh në shkollë e kanë në përkrahjen, ndihmën e mësime të ndihmësve në planifikimin e mësimit;
- 12.5% prej tyre pohojnë se angazhimet më të mëdha të pedagogut të shkollës kanë të bëjnë me kontrollimin e planeve dhe programeve vjetore, mujore dhe përgatitjeve ditore të mësime të ndihmësve;

Raport hulumtimi

- 8.3% kemi përgjigjet se angazhimin më të madh pedagogu e ka në;
 - mbajtjen e ligjëratave, dhënien e këshillave, punën me nxënës me sjellje jo të rregullta;
 - konsultimet me mësime dhënë;
 - përkrahje dhe punë këshilluese me prindër;
- 4.2% angazhime me nxënës problematik, hospitime, me këshillin e nxënësve, përkrahjen e iniciativave të nxënësve;
- 4.2% punë këshilluese me nxënës, mësime dhënë, prindër përgatit dosje pedagogjike të mësime dhënëve zëvendëson mësime dhënësit që mungojnë, bashkëpunon me psikologun për regjistrimin e fëmijëve në shkollë;
- 4.2% e pedagogëve të shkollës organizojnë hulumtime, ligjëratat, këshillime individuale për mësime dhënë dhe nxënës;
- 4.2% bëjnë regjistrimin e fëmijëve në klasë të parë, ndarjen e nxënësve në klasa, punë me nxënës me nevoja të veçanta;
- 4.2% përcjellin punën e aktiveve, analizojnë suksesin, bëjnë biseda për ngecjet, planë çka duhet të ndryshohet, bashkëpunojnë me mësime dhënë për aktivitete të lira;

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

- 4.2% bëjnë hospitime në orë mësimore, marrin pjesë aktive në takime me prind, konsultime me nxënës problematik;
- 4.2% marrin pjesë në aktivet profesionale, mbledhjet me prind, mbledhje të këshillit të arsimtarëve, të këshillit të nxënësve;
- 4.2% mbajnë ligjërata me mësimdhënës dhe nxënës, bashkëpunon me: udhëheqjen e shkollës për organizime të ndryshme, me mësimdhënës dhe nxënës, me rininë shkollore.

Nga të dhënat shohim se angazhimi i pedagogut të shkollës është i shumanshëm. Punën më të madhe e bënë në përkrahjen, ndihmën e mësimdhënësve në planifikimin e mësimit. Në këtë drejtim, pedagogu i përkrah mësimdhënësit në:

- Planifikimin vjetor dhe mujor- rezultatet mësimore që do të arrihen me nxënës brenda vitit/muajit shkollor, përmbajtjen dhe metodologjinë e përzgjedhur;
- Përgatitjet ditore, respektivisht përgatitjet për orë mësimore, shkoqitjen nga plani vjetor të rezultateve mësimore që do arrihen gjatë orës/orëve mësimore brenda një dite, duke u siguruar se rezultatet janë hartuar qartë

Raport hulumtimi

dhe për nivelin e caktuar të shkollimit;

- Planifikimi i aktiviteteve mësimore.

Rregullisht kontrollon planet dhe programet vjetore, mujore dhe përgatitjet ditore. Kjo duhet të bëhet në mënyrë sistematike për t'u siguruar se rezultatet e planifikuara, përmbajtjet mësimore dhe metodologjia e punës janë në harmoni me moshën e nxënësve dhe strukturën e klasës për të cilën është bërë planifikimi. Por, në të vërtetë a ndodh kjo? Në bazë të të dhënave që kemi nga hulumtimi, mund të themi se kontrollimi i planeve dhe programeve vjetore, mujore dhe përgatitjeve ditore/ për orë mësimore bëhet formalisht, jo në detaje. Zakonisht, kërkohen disa detaje që sipas mësimdhënësve janë më të rëndësishme, të cilat edhe janë paraqitur edhe në modelet e planifikimit, si: Tema (përmbajtja), numri i orëve të planifikuara, shpërndarja e orëve të planifikuara (zhvillim, ushtrime, përsëritje), mjetet e punës, metodat e punës dhe teknikat mësimore.

Pedagogu mbanë evidencë për planet dhe programet e kontrolluara dhe dokumentacionin pedagogjik.

Ndihmon mësimdhënësit rreth përgatitjeve ditore, i kontrollon përgatitjet ditore të mësimdhënësve si dhe jep

udhëzimet e nevojshme.

Pedagogu i shkollës mbanë ligjërata me mësimdhënës por edhe me nxënës për tema të ndryshme. Temat më të shpeshta të cilat i ligjëron për nxënës janë:

- Informimi dhe orientimi profesional;
- Pirja e duhanit-dëmet dhe pasojat;
- Dhuna fizike në shkollë;
- Siguria në shkollë dhe jashtë saj;
- Vijueshmëria në shkollë, etj.

PËRKRAHJA E MËSIMDHËNËSVE NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT


Planifikimi i mësimit, patjetër duhet të bëhet pjesë e punës së përditshme e pedagogut të shkollës, sepse kjo e ndihmon në masë të madhe punën e mësimitdhënësve si dhe ndihmon në organizimin bashkëkohor të procesit mësues dhe ngritjen e cilësisë dhe arritshmërive në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie.

Ndihma rreth planifikimit të mësimit

Një nga detyrat kyçe të pedagogut të shkollës është të ndihmojë mësimitdhënësit në planifikimin e mësimit.

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

Në pyetjen e parashtruar mësimdhënësve: *Nëse keni nevojë për ndihmë rreth planifikimit të mësimit, nga kush e kërkon (merrni) këtë ndihmë?*- kemi marrë përgjigje se këtë ndihmë e marrin nga pedagogu, drejtori dhe mësimdhënësit (kolegët).



Grafiku 6. Ofruesit e ndihmës për mësimdhënësit

Numri më i madh i pedagogëve, 38.92%, pohojnë se mësimdhënësit kërkojnë ndihmë dhe ndihmohen vetëm nga pedagogu i shkollës, 22.7%, pohojnë se mësimdhënësit ndihmohen nga kolegët e tyre, pra vetëm nga mësimdhënësit, 20.8%, pohojnë se ndihmohen nga pedagogu dhe mësimdhënësit, 8.4%, ndihmohen nga drejtori, pedagogu dhe mësimdhënësit, 7.8%, pohojnë se ndihmohen nga drejtori dhe pedagogu, 2.6%, vetëm nga drejtori, 2.6%, nga askush- përvoja e bënë të veten, ndërsa 1.3%, nga drejtori dhe mësimdhënësit.

Në grafik shohim se, në rast se mësimdhënësve u nevojitet ndihmë, atëherë fillimisht këtë e kërkojnë nga pedagogu i shkollës, por, natyrisht se ndihmë dhe përkrahje ju ofrohet edhe nga ana e drejtorit dhe kolegët e tyre mësimdhënës.

Cila është ndihma apo përkrahja që ju ofron pedagogu i shkollës në planifikimin e mësimet?- ishte pyetja e radhës që kemi parashtruar për mësimdhënës. Nga mësimdhënësit kemi marrë këto përgjigje:

- Në hartimin e planeve mësimore;
- Varësisht nga lloji i kërkesave;
- Në kualitetin (cilësitë) që do të arrijmë në procesin

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

edukativo-arsimor;

- Informacione shtesë për atë që nuk e kemi të qartë;
- Mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Sugjerime rreth përgatitjeve ditore;
- Monitorim, këshillim, reflektim, ndihmë, mbështetje;
- Këshilla si ta mbajmë orën mësimore;
- Këshilla pedagogjike, këshilla për menaxhimin e klasës;
- Planifikimin dhe organizimin e mësimit shtues dhe plotësues;
- Përdorimin e materialeve mësimore;
- Rreth planeve të praktikës profesionale, etj.

Ka edhe mësimdhënës të tillë që mendojnë se nuk kanë nevojë për ndihmë por nëse paraqitet nevoja kërkojnë ndihmë nga pedagogu. Nga 0.03% e mësimdhënësve kemi marrë përgjigje që ndihma/përkrahja që ofrohet nga pedagogu është e vogël, më tepër kërkojnë ndihmë nga drejtori duke u arsyetuar se “ ...ndoshta ne vetë jemi mësuar me drejtorin, se pedagog nuk kemi pasur deri para dy viteve”. Edhe pse është numër mjaft i vogël i mësimdhënësve që japin përgjigje të tillë, kjo do të duhej të ishte shqetësuese për pedagogët e shkollave.

Raport hulumtimi

Mësimdhënësit, kanë njohuri të mjaftueshme për përmbajtjen mësimore që do t'u ofrohet nxënësve. Është e domosdoshme që kjo përmbajtje, nxënësve t'u ofrohet në mënyrën sa më të përshtatshme. Në këtë drejtim, pedagogu jep kontributin e tij duke udhëzuar mësimdhënësit për metodologjinë e punës me nxënës, për përmbajtjen që do të ofrohet.

Sfidat gjatë planifikimit të mësimit


Gjatë planifikimit të mësimit paraqiten edhe sfida të ndryshme. Si sfidë për shkollën, pedagogët e shohin bartjen e planifikimeve nga një vit në tjetrin (kopjimin e planeve mësimore), si dhe punën jo të kënaqshme në planifikimin e mësimit. Sipas tyre, planifikimi i mësimit nga mësimdhënësit, nuk është në nivelin e duhur dhe sfidat e mësimdhënësve në hartimin e planeve mësimore janë të mëdha. Mungon puna e përbashkët e mësimdhënësve.

Sipas të dhënave që kemi nga pedagogët e shkollave del se sfiduese për mësimdhënësit gjatë planifikimit të mësimit janë:

- Mungesa e teksteve mësimore;

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT


- Mungesa e mjeteve të konkretizimit;
- Përgatitja jo e mjaftueshme didaktike-metodike e mësimdhënësve;
- Mospërputhja e teksteve mësimore;
- Ngarkesa e programeve mësimore në krahasim me moshën e nxënësve;
- Mospërgatitja adekuate e disa mësimdhënësve për disa lëndë mësimore;
- Mospërputhja e teksteve me Planin dhe Programin Zyrtar;
- Prezenca e teksteve alternative;
- Përgatitja me shkrim e plankonspekteve (përgatitjet për orë mësimore);
- Organizimi i praktikës profesionale;
- Aspekte metodologjike;
- Mosinteresimi i një pjese të prindërve për bashkëpunim;
- Planifikimi i punës për fëmijë me nevoja të veçanta;
- Kopjimi i planeve-përcjellja vit pas viti;
- Kthimi i objektivave mësimore në rezultate mësimore;
- Shkoqitja e rezultateve vjetore, mujore, ditore;
- Ndarja e fondit të orëve në periudha të ndryshme;
- Mosrealizimi i planeve mujore për arsye të ndryshme.



Grafiku 7. Sfidat e mësimitdhënësve gjatë planifikimit të mësimit

Në grafik shohim se, sipas pedagogëve, sfidat më të mëdha të mësimitdhënësve gjatë planifikimit të mësimit paraqiten si pasojë e përgatitjes jo të mjaftueshme të mësimitdhënësve në aspektin didaktik-metodik. Mungesa e teksteve mësimore për nivelin 6-9 dhe 9-12. Ekzistenca e teksteve alternative si dhe mospërputhja e teksteve me Planet dhe Programet Zyrtare, sipas pedagogëve paraqiten shpeshherë si dukuri sfiduese për mësimitdhënësit gjatë planifikimit të mësimit, por në bashkëpunim këto po kalohen. Në pyetjen e parashtruar mësimitdhënësve se: *Cilat janë sfidat me të cilat ata ballafaqohen gjatë planifikimit të mësimit?*- kemi marrë këto përgjigje:

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT



Grafiku 8. Sfidat e mësimdhënësve gjatë planifikimit të mëimit

Raport hulumtimi

Sipas të dhënave të marra nga mësimdhënësit, që pasqyrohen në grafikun 8, del se mësimdhënësit gjatë planifikimit të mësimit hasin në sfida të ndryshme. Numri më i madh i mësimdhënësve, sfidë e paraqesin mungesën e mjeteve mësimore. Mungesa e mjeteve mësimore sipas tyre, shpeshherë pamundëson planifikimin e disa aktiviteteve të cilat do ishin shumë atraktive për nxënës.

Mungesa e mjeteve të konkretizimit dhe lidhja e teorisë me praktikën, paraqesin sfidë mjaft të madhe për mësimdhënësit.

Nga të dhënat, shohim se nuk kemi dallime të mëdha mes opinionëve të pedagogëve dhe mësimdhënësve. Kjo dëshmon se pedagogu e përcjell vazhdimisht punën e mësimdhënësve në planifikimin e mësimit.

Nëse krahasojmë përgjigjet e pedagogëve dhe mësimdhënësve, mund të pajtohemi me konkludimin e pedagogëve, se sfiduese për mësimdhënësit, është përgatitja jo e mjaftueshme e mësimdhënësve në aspektin didaktik-metodik. Po të ishte në nivelin e duhur përgatitja didaktike-metodike, mësimdhënësit nuk do përballëshin me shumicën e vështirësive me të cilat pohojnë se përballen, si: zgjedhjen adekuate të metodave të

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

mësimdhënies, planifikimin e mbështetur në rezultate të pritura, integrimin e lëndëve, përshtatjen e njësive mësimore me kushtet dhe mundësitë që ofron shkolla, përdorimin e teksteve mësimore dhe ngarkesën e tyre, realizimin e planeve mësimore, etj.

Pedagogu angazhohet dhe ndihmon nxënësit për tejkalimin e situatave sfiduese.

Ai, u sugjeron dhe i ndihmon mësimdhënësit në planifikimin dhe arritjen e rezultateve mësimore me nxënë, duke i këshilluar që mos të mbesin “brenda kornizave të tekstit shkollor”. Gjithashtu, u jep informacione rreth përdorimit të teksteve alternative.

Aspekti metodologjik dhe mungesa e mjeteve të konkretizimit po ashtu është sfiduese për mësimdhënësit. Shumica e mësimdhënësve, janë përfshi në trajnime të ndryshme për zbatim të metodologjive, por ka mësimdhënës që nuk janë përfshi dhe të tillë që edhe pse janë përfshi nuk tregojnë gatishmëri për aplikim të metodave të reja në praktikën mësimore. Pedagogu me përgatitjen që ka, u ndihmon mësimdhënësit në planifikimin dhe aplikimin e metodave të reja mësimore.

Dukuri shqetësues duket të jetë edhe përcjellja e planeve

Raport hulumtimi

mësimore të njëjta për disa vite - kopjimi i tyre. Sipas pedagogëve, kjo problematikë po tejkalohet dhe pse rastet e tilla janë zvogëluar dukshëm në krahasim me vitet tjera. Gjatë kontrollimit të planifikimeve mësimore, pedagogu analizon nëse janë përzgjedhur përmbajtjet mësimore adekuate, sa ato i kontribuojnë rezultateve mësimore dhe sa janë aktuale. Nëse është e nevojshme, mësimdhënësve iu ndihmon në caktimin e rezultateve mësimore. “Rezultatet mësimore i marrim nga Planet dhe Programet Zyrtare. Aty kemi objektiva mësimore të cilat i kthejmë në gjuhën e rezultateve mësimore. Fillimisht, caktojmë rezultatet që do mbërrihen gjatë vitit shkollor. Nga rezultatet vjetore ndajmë rezultatet mujore, dhe rezultatet që do të mbërrihen brenda orës mësimore. Për mësimdhënësit në fillim ka qenë një punë e vështirë. Është dashur kohë dhe punë sistematike në aktivet profesionale. Mirëpo, tani mësimdhënësit i kanë të qarta këto çështje. Sfiduese është për mësimdhënësit e ri, por i inkurajojmë që të bashkëpunojnë me ne dhe mësimdhënësit e tjerë edhe në këtë drejtim.”(Sh.B. Pedagoge, intervistuar me datë 01.04.2014).

Kontributi i pedagogut në hartimin e planeve mësimore

Planifikimi i mësimave bëhet nga ana e mësimitdhënësve në bashkëpunim me pedagogun e shkollës. Pedagogu i shkollës luan një rol të rëndësishëm në planifikimin e mësimave. Ai, përkrah/ndihmon mësimitdhënësit në hartimin dhe realizimin e planeve dhe programeve mësimore. Sugjeron, dhe në bashkëpunim me mësimitdhënësin dizajnon modele të planifikimit mësimor, të cilat aprovohen nga drejtori dhe Këshilli drejtues i shkollës.

Gjatë hulumtimit në shkollë, sigurojmë edhe modelet e planifikimit të mësimave me të cilat punojnë mësimitdhënësit. Modelet e planifikimit të mësimave dallojnë nga shkollë në shkollë. Në shkollat e përfshira në hulumtim, patëm rastin të shohim modele të ndryshme të planeve vjetore, mujore dhe përgatitjeve ditore.

Raport hulumtimi

Temat Mësimore	Fondi vjetor i orëve			Muajt e vitit											
				Shtator			Tetor			Nëntor				
	zh	p	gj	zh	p	gj	zh	p	gj	zh	p	gj	Zh	p	gj
Gjithsej orë															

Figura 1. Modeli 1 i planifikimit vjetor që përdoret në disa shkolla

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

Muaji	Nr. i temave	<i>Temat mësimore</i>	Zhvillim	Përsëritje	Ushtrime	Gjithsej
Shtator						
Tetor						
Nëntor						
Dhjetor						
Mësimi plotësues			Mësimi shtues			

Figura 2. Modeli 2 i planifikimit vjetor

Raport hulumtimi

Në figurat 1 dhe 2 shohim se kemi dy modele të planifikimit vjetor për lëndë mësimore në të cilat paraqiten temat dhe fondi vjetor e mujor i orëve të ndara sipas tipit të orës.

Në asnjërin nga modelet e planifikimit nuk i shohim rezultatet mësimore që do mbërrihen me nxënës gjatë vitit shkollor.

Instrumentet për planifikim mujor janë të përafërta, dallojnë në disa detaje.

JAVA	Njësitë mësimore	Tipi i orës	Mjetet mësimore	Metodat e punës	Teknikat mësimore
I					
II					

Figura 3. Modeli 1 i planifikimit mujor

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

Java	Orët	Njësitë mësimore	Tipi i orës	Metodat mësimore	Format mësimore	Mjetet nësimore	Objektivat

Figura 4. Modeli 2 i planifikimit mujor

Figurat 3 dhe 4, pasqyrojnë modelet e planifikimit mujor dhe përdoren në shkollat ku është shtri hulumtimi. Siç duket, shumica e shkollave punojnë me objektiva dhe jo me rezultate mësimore.

Raport hulumtimi

Përmes hulumtimit, kemi marrë opinione nga mësime të ndryshme në lidhje me hartimin e planeve mësimore.

Për mësime të ndryshme kemi parashtruar pyetjen: *Kush i harton planin mësimore në shkollën tuaj?*

Nga të dhënat që morëm nga hulumtimi, del se planin mësimore hartohen nga vet mësime të ndryshme dhe shkollës.


➤ 73.8% e mësime të ndryshme pohojnë se planifikimet mësimore i hartojnë mësime të ndryshme dhe lëndëve apo klasave,

➤ 14 % pohojnë se planin mësimore i harton aktiviteti i klasës,

➤ 12.2 % pohojnë se planin mësimore i hartojnë mësime të ndryshme dhe aktivitetet profesionale.

Në pyetjen e drejtuar mësime të ndryshme, se: *Planifikimet që përgatitni, a mundësojnë mësime të ndryshme dhe nxënien cilësore?*- kemi marrë këto përgjigje:

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT



Grafiku 9. Mësimdhënia dhe mësimnxënia cilësore përmes planeve dhe programeve mësimore

Në grafikun 9 shohim se shumica e mësimdhënësve pohojnë se planifikimet mësimore që përgatisin ofrojnë mësimdhënie cilësore. Këtë fakt e pohojnë 57.9% e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim. 40.2% e mësimdhënësve pohojnë se planifikimet mësimore që përgatisin pjesërisht ofrojnë mësimdhënie cilësore ndërsa 1.9% e mësimdhënësve pohojnë se aspak nuk ofrojnë mësimdhënie cilësore.

Përcjellja e planifikimit përmes monitorimit të mësimit

Monitorimi i mësimit është pjesë e planit të punës së pedagogut. Përmes monitorimit të mësimit, pedagogu përcjell punën e mësimitdhënësve dhe realizimin e aktiviteteve të planifikuara paraprakisht. Nga të dhënat që kemi marrë nga respondentët e përfshirë në hulumtim, del se pedagogët në planin e punës parashohin edhe monitorimin e mësimitdhënësve në orë mësimore, me qëllim të mbledhjes sistematike të të dhënave për të parë realizimin e aktiviteteve, synimeve, qëllimeve, objektivave dhe rezultateve të planifikuara.

Pedagogu, monitorimin e mësimitdhënësve e bënë në mënyrë sistematike. Atë e bënë, për të vlerësuar se sa dhe si zbatohen aktivitetet mësimore të planifikuara për vitin, muajin apo orën mësimore. Ai, organizon monitorime me qëllime specifike.

Të gjithë pedagogët pohojnë se shpesh i monitorojnë mësimitdhënësit në orë mësimore. Këtë fakt e argumentojnë shumica e mësimitdhënësve, ku 79.5%, prej tyre pohojnë se janë të shpeshta vizitat- monitorimet në orë mësimore nga ana e pedagogut të shkollës, ndërsa 20.5% e

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

mësimdhënësve pohojnë se pedagogu monitoron në orë mësimore por vizitat- monitorimet e tij nuk janë të shpeshta.

Gjatë monitorimit të mësimit, pedagogu i shkollës, e ka rolin e ndihmësit, përkrahësit, lehtësuesit, sepse me këshillat, sugjerimet dhe rekomandimet u ndihmon, mësimdhënësve në punën e tyre me nxënës.

Pedagogu, në programin operativ, cakton kohën kur monitoron në orë mësimore. Monitorimi, zakonisht paralajmërohet me kohë nga ana e pedagogut. Paralajmërimet bëhen me shkrim dhe vendosen disa ditë/javë para fillimit të monitorimeve.




Figura 5. Model i lajmërimit për monitorime

Sipas pedagogëve të përfshirë në hulumtim, monitorimi i mësimit kalon në disa faza/etapa:

Faza e parë: Intervista me mësime

Para fillimit të orës mësimore, pedagogu i shkollës diskuton me mësime rreth orës mësimore që do të monitorohet. Diskutohet rreth planifikimit, përgatitjes me shkrim për orë mësimore, për temën mësimore që do të realizohet, për objektivat e temës mësimore, metodologjinë që ka përzgjedhur për arritjen e

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

objektivave, për çfarë arsye e ka përzgjedh atë metodologji mësimdhënësi, për rezultatet që pret të arrijë me nxënësit deri në përfundim të orës mësimore, etj.

Faza e dytë: Monitorimi i mësimit

Në këtë fazë pedagogu mban shënim për veprimtaritë që ka për qëllim t'i monitoroj. Përcjell me vëmendje secilin aktivitet, shënon në formularin përkatës për monitorim/fletoren për monitorim të gjitha detajet, komentet, vërejtjet dhe sugjerimet.

Faza e tretë: Intervista II

Pas përfundimit të orës mësimore/monitorimit, pedagogu i shkollës zhvillon prapë intervistë më mësimdhënësin që ka qenë pjesë e monitorimit.

Fillimisht, merr mendimin e mësimdhënësit për ecurinë e orës mësimore. A është realizuar ora mësimore sipas planifikimit, a janë përmbushur objektivat/rezultatet e planifikuara? etj.

Faza e katërtë: Komentet dhe sugjerimet e monitoruesit

Në këtë fazë, monitoruesi jep komentet e tij në lidhje me orën e monitoruar.

Shumica e pedagogëve të përfshirë në hulumtim posedojnë formularë për monitorimin e mësimdhënësve gjatë një ore mësimore. Gjatë hulumtimit në terren dhe diskutimeve me pedagogë shkolle, kemi marrë opinione edhe për formularët e monitorimit. Patëm rastin të shohim pesë modele të ndryshme të formularëve të monitorimit.

Tre nga formularët ose 60% e formularëve të analizuar ishin dizajnuar më tepër si formë për përshkrimin e orës mësimore.

<p>Struktura e orës</p> <p>Pjesa hyrëse (Evokimi-E)_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>Pjesa kryesore (Realizimi i kuptimit-R)_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>Pjesa përfundimtare (Reflektim-R)_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>Vërejtje:</p> <p>_____</p> <p>_____</p>

Figura 6. Pjesë e shkëputur nga formulari i hospitimit 2 të orës mësimore

Raport hulumtimi

Vështrimet gjenerale të monitoruesit/es
Arritshmëria e realizimit të objektivave: a) Plotësisht b) Kënaqshëm c) Jo kënaqshme
Anët pozitive gjatë realizimit të orës mësimore
Problemet kryesore të konstatuara në orën e mësimit:
Zgjedhjet e propozuara

Figura 7. Modeli 2 i formularit për monitorimin e mësimdhënësve

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

Nga formularët e hospitimit me narracion, 33.33% prej tyre përveç pjesës narrative, kishin edhe pjesën e vlerësimit, ku monitoruesi vlerëson nivelin e realizimit të treguesve të vendosur.

Nr	Treguesit për mësimdhënien dhe të nxëniet efektiv	a) Plotësisht i kënaqshëm b) Kënaqshëm c) Jo i kënaqshëm
1	Mësimdhënësi ka qartësuar objektivat për nxënësit	a) b) c)
2	Mësimdhënësi jep udhëzime dhe shpjegime të qarta	a) b) c)

Figura 8. Mostër e hospitimit të orës mësimore

Siç shihet, formularët e monitorimit kanë për qëllim vlerësimin e orës mësimore.

Dy ose 40% e formularëve të analizuar, madje, titulloheshin si formular për vlerësimin e orës mësimore, ndërsa tre ose 60% prej tyre, titulloheshin formularë për hospitimin e orës mësimore.

Në të gjithë formularët që përdorëshin për hospitim/monitorim, fillimisht kërkoheshin të dhënat për mësimdhënësin si emri dhe mbiemri, pastaj të dhëna për

Raport hulumtimi

klasën dhe lëndën mësimore. Në 80% të formularëve kërkohej të shënohej njësia mësimore, ndërsa në 20% nuk kërkohej të shënohej njësia mësimore. Vetëm në 20% të formularëve, kërkohej të shënohet lloji dhe qëllimi i monitorimit.

Vetëm në 20% të formularëve kërkohej të evidentoheshin; a i ka mësimdhënësi planet vjetore, planet mujore dhe përgatitjet me shkrim për orë mësimore.

Në 60% të formularëve për monitorim/vlerësim të orës mësimore (Kështu titullohen formularët që pedagogët e shkollave i përdorin për monitorimin e mësimit) , vlerësimi bëhet me kritere të përcaktuara paraprakisht në formë tabelare, p.sh.

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

Kriteri	Indikatorët	Vlerësimi				Komente
		++	+	-	--	
Struktura e mësimit	<ul style="list-style-type: none"> • Ora mësimore ka strukturë të qartë e cila është transparente për nxënës • Fazat e mësimit janë të ndara mirëpo përputhen njëra me tjetrën 					

Figura 9. Pjesë e shkëputur nga formulari për hospitim 1

Siç shihet në figurën 9, për një kriter janë përcaktuar disa indikatorë për vlerësimin e orës mësimore. Plotësimi i tabelës bëhet vetëm me një “√”. Po ashtu edhe vlerësimi është bërë me disa shenja identifikuese: ++ që e ka kuptimin shumë mirë, + ka kuptimin mirë, - ka kuptimin jo mirë, - - ka kuptimin dobët.

Raport hulumtimi

Nr	ECURIA E ORËS MËSIMORE	Mirë	Mesatar	Jo mirë	Vërejtje
1	Fillimi i orës mësimore				
2	Qasja dhe komunikimi me nxënës				
3	Aplikimi i reformave, metodologjia e mësimdhënies				
				

Figura 10. Pjesë e shkëputur nga formulari për hospitim 2

Figura 10, pasqyron një model tjetër të formularit për monitorim. Edhe me këtë model/formular monitorimi, vlerësimi bëhet po ashtu me kritere të përcaktuara paraprakisht. Ky model i monitorimit është jo analitik dhe jo shumë i qartësuar, ngase nuk na ofron mundësinë të marrim informacione të qarta për indikatorët të cilët vlerësohen. Te indikator nr.1, fillimi i orës mësimore, monitoruesi e vlerëson me një “√” në njërën nga nivelet e arritshmërisë; mirë, mesatar, jo mirë dhe jep vërejtjet eventuale por, ne nuk shohim askund argumente për një vlerësim të tillë.

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

Struktura e orës	Teknikat e mësimdhënies	Koha
Evokim		
Realizim		
Reflektim		

Tabela 11. Pjesë e shkëputur nga formulari për hospitim 3

Tabela 11 pasqyron një model tjetër monitorimi, në të cilin, prioritet kanë teknikat e mësimdhënies dhe koha në dispozicion për zbatimin e tyre.

Kriteret e përcaktuara në formularët e monitorimit, i vlerësojnë disa aspekte të cilësisë, si: Shfrytëzimin efektiv të orës mësimore, krijimin e klimës pozitive në klasë, metodologjinë e punës dhe përcjelljen dhe kontrollimin e njohurive të nxënësve.

Nga formularët e monitorimit të analizuar, kuptojmë se ende në shumicën e shkollave të përfshira në hulumtim punohet me objektiva e jo me rezultatet mësimore, sepse në 60% të formularëve për monitorim, kërkohej të shënoheshin objektivat mësimore si dhe të vlerësohet arritja e tyre. Vetëm në 20% kërkohehin rezultatet, ndërsa në 20% prej tyre nuk kërkohej të shënoheshin as objektivat e as rezultatet të cilat priten të arrihen me

Raport hulumtimi

nxënës brenda orës mësimore.

Nga bisedat me pedagogë dhe mësime, kuptuam se, zakonisht të njëjtët formular përdoren në të gjitha monitorimet.

Por, a bëhen gjithëherë monitorimet për të njëjtën arsye?

Cili është qëllimi i monitorimeve?

Këtë pyetje e kemi parashtruar për pedagogët në nivel shkolle dhe për mësime, sepse kemi dashur të kuptojmë, nëse pedagogu i shkollës organizon monitorime për të përcjellur zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, realizimin e rezultateve mësimore, nëse monitorimet ndihmojnë në planifikimet mësimore dhe nëse informacionet e marra nga monitorimi mësimeve iu ndihmojnë në procesin e planifikimit.

Nga të dhënat që kemi marrë nga pedagogët në nivel shkolle, del se qëllimi i monitorimit është vlerësimi i punës së mësimeve.

Nga pedagogët kemi këto të dhëna:

- 20.8% vlerësimi;
- 16.7% kontrollimi, këshillimi;
- 12.5% zbatimi i metodologjisë së re;
- 12.5% përgatitja e mësimeve për orë mësimore;

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

- 8.3% respektimi i etapave të orës mësimore;
- 8.3% rrjedha e procesit mësimor, angazhimi i nxënësve në mësim, metodologjia e punës, përgatitja profesionale e mësimitdhënësve;
- 8.3% suksesi i mësimitdhënësve dhe nxënësve, vlerësimi sistematik, ana metodike, ecuria e orës mësimore;
- 8.3% aspekti metodologjik;
- 4.2 5 realizimi i kurrikulit;
- 4.2% përgatitja për orë mësimore, zotërimi i lëndës, metodologjia e punës, përvetësimi i përmbajtjeve mësimore nga nxënësit, atmosfera në klasë, motivimi i nxënësve, konkretizimi i përmbajtjeve, krijimi i materialeve didaktike;
- 4.2 % përgatitja e mësimitdhënësve për zbatimin e metodave dhe teknikave të punës, ana metodologjike, zbatimi i planeve;
- 4.2% mënyra e shpjegimit të mësimitdhënësve, aplikimi i metodave të reja.

Nga të gjitha këto të dhëna, mund të themi se qëllimi i monitorimit, më tepër na asocion në vlerësimin e performancës së mësimitdhënësit. Këtë, në njëfarë forme e


Raport hulumtimi

“imponon” instrumenti të cilin e përdorin pedagogët për monitorim. Megjithëse, monitorimet jo gjithherë kanë nevojë të bëhen me anë të instrumenteve të shabllonizuara. Pedagogu i shkollës, varësisht prej qëllimit të monitorimit mund të hartojë instrumente për marrjen e shënimeve gjatë monitorimeve në orët mësimore.

Kurse mësimdhënësit, monitorimin e shohin si formë e mbështetjes së tyre në realizimin e mësimdhënies cilësore, si dhe mundësinë e mirë për avancim në profesion.

Në pyetjen e parashtruar mësimdhënësve: Cili është qëllimi i monitorimit të mësimit? Kemi këto të dhëna:

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT



Grafiku 10. Qëllimi i monitorimit sipas mësimit

Në grafik shohim se numri më i madh i mësimit pohojnë se qëllimi i monitorimit është përkrahje, ndihmë dhe këshillim. Këtë fakt e argumentojmë edhe nga formularët e monitorimit, në të gjithë formularët, përfshihet pjesa për komentet, sugjerimet apo zgjedhjet e propozuara nga ana e monitoruesit. Po ashtu, një pjesë e

Raport hulumtimi

madhe e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim, pohojnë se qëllimi i monitorimit, është vlerësimi i punës së mësimdhënësit me qëllim të avancimit të tij. Sipas tyre, këshillat, vërejtjet dhe sugjerimet që marrin nga pedagogu pas monitorimit u ndihmojnë atyre, të avancohen, të zhvillohen profesionalisht.

Sipas mësimdhënësve, monitorimi bëhet për qëllim të mbarëvajtje të procesit mësimor, ngritjen e cilësisë në mësim, realizimin e orës mësimore, suksesin e nxënësve, punën me nxënës dhe përshtatjen e planeve ditore me ato mujore dhe vjetore.

Këshillat, vërejtjet dhe sugjerimet, zakonisht jepen në fazën e fundit të procesit të monitorimit, pra, pas përfundimit të monitorimit të orës mësimore dhe intervistës me mësimdhënësin.

Për të konstatuar se a jepen çdoherë vërejtje, këshilla dhe sugjerime nga ana e monitoruesit/pedagogut, për respondentët e përfshirë në hulumtim kemi parashtruar pyetjen: Çka pas monitorimit?


Të gjithë pedagogët në nivel shkolle të përfshirë në hulumtim, pohojnë se pas analizës së orës mësimore që e bëjnë bashkë me mësimdhënësin japin këshilla, vërejtje,

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

udhëzime dhe sugjerime, ndërsa vetëm 8.4% bëjnë raporte me shkrim.

Këshillat, sugjerimet, udhëzimet lidhen edhe me planifikimin mësimor dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.

Ndërsa, nga mësimdhënësit kemi edhe të dhëna se jo gjithëherë marrin këshilla, vërejtje apo sugjerime.



Grafiku 11. A marrin mësimdhënësit këshilla, vërejtje apo sugjerime pas monitorimit

Në grafikun 11 shohim se 49.70% e mësimdhënësve pohojnë se gjithëherë pas monitorimit marrin këshilla, vërejtje apo sugjerime, 44.40% prej tyre pohojnë se nganjëherë marrin këshilla, vërejtje apo sugjerime ndërsa 5.9% prej tyre pohojnë se asnjëherë nuk marrin këshilla, vërejtje e as sugjerime.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përfundime

Nga analiza e dokumenteve zyrtare dhe hulumtimi, mund të nxjerrim këto përfundime:

- Deri në maj të vitit shkollor 2014-2015 kanë qenë të inkuadruar 24 pedagogë në shkolla të ndryshme në 12 komuna;
- Në Ligjin për Arsimin Parauniversitar, pedagogët përfshihen në kuadër të konceptit: Personeli profesional jomësimdhënës;
- Në Udhëzimin Administrativ MASHT nr.34, Funkzioni i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla, pedagogët emërtohen si bashkëpunëtorë profesional që parashihen në kuadër të shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë;
- Sipas udhëzimit Administrativ MASHT nr.34, Funkzioni i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla, pedagog i shkollës është personi i cili ka përfunduar studimet e nivelit Master në Degën e Pedagogjisë të Fakultetit Filozofik përkatësisht Fakultetin e Edukimit, studimet katërvjeçare në Degën e Pedagogjisë, apo siç është rregulluar me UA 2014 për licencimin e mësimdhënësve

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

dhe bashkëpunëtorëve profesional;

- Detyrat e punës së pedagogut të shkollës orientohen në organizimin e punës drejt realizimit të detyrave të planifikuara në planin zhvillimor të shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit, në harmoni me dokumentet zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe në bazë të planifikimit dhe realizimit të punës së gjithëmbarshme në shkollë;

- Angazhimi më i madh i pedagogut, ka të bëjë me përkrahjen, ndihmën e mësimdhënësve në planifikimin e mësimt;

- Pedagogu i shkollës merr pjesë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe realizimin e punës edukative në shkollë;

- Mësimdhënësit kërkojnë ndihmë dhe ndihmohen në masë të madhe nga pedagogu i shkollës;

- Pedagogu i përkrah mësimdhënësit në planifikimin vjetor dhe mujor, respektivisht në hartimin e rezultateve mësimore që do arrihen me nxënës brenda vitit/muajit shkollor, përmbajtjen dhe metodologjinë e përzgjedhur, planifikimin e aktiviteteve mësimore, ndihmon mësimdhënësit në përgatitjet për orë mësimore, i

Raport hulumtimi

kontrollon planet dhe programet mësimore, përgatitjet ditore të mësimdhënësve si dhe u jep udhëzimet e nevojshme;

- Mësimdhënësit gjatë planifikimit të mëimit hasin në sfida të ndryshme, e që për tejkalimin e tyre mësimdhënësit pedagogun e shohin si personin kyç;

- Monitorimin nga ana e pedagogut mësimdhënësit e shohin si formë të mbështetjes që ofrohet për realizimin e mësimdhënies cilësore, si dhe mundësi e mirë për avancim në profesion, sepse këshillat, vërejtjet dhe sugjerimet që marrin nga monitoruesi/ pedagogu u ndihmojnë atyre të avancohen, të zhvillohen profesionalisht.

Nga të gjitha këto që u cekën më lartë, mund të vijmë në përfundim se hipotezat e parashtruara para fillimit të hulumtimit si të tilla janë vërtetuar, sepse pedagogu i shkollës ka rol të rëndësishëm në planifikimin e mëimit, ndihmon mësimdhënësit e shkollës gjatë procesit të planifikimit si dhe në mënyrë sistematike përcjell punën e mësimdhënësve në shkollë.

Rekomandime:

Nga përfundimet e pasqyruara më lartë, dalin edhe disa rekomandime kryesore, si:

- Meqë pedagogët vazhdimisht përcjellin punën e mësimeve në shkollë, është e nevojshme që të përfshihen në të gjitha trajnimet e mundshme që ofrohen për mësuesit e sidomos në trajnimet për zbatimin e kurrikulit dhe trajnimet për planifikimin e mësimit;
- Të krijohet një rrjet bashkëpunimi dhe komunikimi mes pedagogëve në shkollë në mënyrë që të shkëmbehen përvojat mes tyre;
- Pedagogët të informohen me kohë me risitë, ndryshimet që ndodhin në fushën e planifikimit të mësimit, sidomos për nivelin arsimor në të cilin punojnë;
- Informacionet e marra t'i përcjellin me kohë në shkollë, t'i ndajnë informacionet dhe përvojat me mësuesit;
- T'i nxisin mësuesit që gjatë planifikimit të mësimeve të orientohen në arritjen e rezultateve mësimore që parashihen në Planin dhe Programet Zyrtare;
- Në mënyrë sistematike të mentorojnë dhe monitorojnë punën e mësuesve në shkollë;

Raport hulumtimi

- Të përkrahin mësimdhënësit gjatë hartimit dhe realizimit të aktiviteteve mësimore të planifikuara;
- Të angazhohen për ngritjen profesionale të mësimdhënësve të shkollës duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e tyre në planifikimin e mësimi;
- Të krijojnë klimë bashkëpunuese në shkollë, në mënyrë që komuniteti i shkollës t'i shohë si mbështetës, ndihmës, lehtësues, këshillues, udhëzues, novator, bashkëpunëtorë të ngushtë në aspektin profesional e social;

Mësimdhënësit dhe komuniteti i shkollës të jenë të zëshëm dhe të kërkojnë vazhdimisht shërbime profesionale pedagogjike nga ana e pedagogut të shkollës.

REFERENCA DHE BIBLIOGRAFI

Dokumente zyrtare

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, (2002), Ligji për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, Institucionet e përkohshme vetëqeverisëse, Prishtinë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, (2011), Ligji për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-32, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Prishtinë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, (2003), Udhëzimi administrativ nr. 04/2003, Organet Qeverisëse, profesionale dhe personeli tjetër i shkollës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, (2013), Udhëzimi Administrativ nr. 26/2013, Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukative-arsimore parauniversitare.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, (2014), Udhëzimi Administrativ nr. 34/2014, Funkcioni i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla.

Revistat

Lidhja e shoqatave të pedagogëve të KSA të Kosovës, (1985), Pedagogu- Pedagog, nr. 1, Prishtinë.

Shkëndija, nr. 7, shtator, 2007.

Materiale nga interneti

Thaçi, I. (2014, Maj, 03). Me çka merret pedagogu në shkollë dhe a ka nevojë për të, <https://www.facebook.com/IsaThaciKeshillaPsikologjike/posts/850838001598173>- shkarkuar më 20.05.2014.

Telegrafi, (2014, Prill, 18), Kthimi i pedagogëve në shkolla më se i nevojshëm, <http://www.telegrafi.com/lajme/kthimi-i-pedagogeve-ne-shkolla-me-se-i-nevojshem-2-43585.html>, - shkarkuar më 23.04.2014.

Programi për punën e pedagogut në vitin shkollor 2009/2010, (pa datë), <http://sandesterjoski.at.ua/index/pedagogu/0-30-> shkarkuar më 23.04.2014, shkarkuar më, 11.06.2015.

Kuvendi Komunal i Rahovecit, Rregullore për organizimin e punës dhe të mësimin në shkollat e mesme të larta në komunën e Rahovecit, miratuar në Rahovec më 30.03.2012, në <https://kk.rks.gov.net/rahovec/getattachment/Municipality/Assembly/Regulations/RREGULLORE-PER-SHML-1-.pdf.aspx>- shkarkuar më, 23.04.2014.

ROLI I PEDAGOGUT NË PLANIFIKIMIN E MËSIMIT

Botues
Instituti Pedagogjik i Kosovës

Korrektor gjuhësor
Mirjeta Gashi

Shtypi
“SOLAR”

Prishtinë
2015

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37(047)

Bytyqi-Beqiri, Lirije

Roli i pedagogut në planifikimin e mësimin : raport hulumtimi / Lirije Bytyqi-Beqiri, Gani Gajraku. – Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2015. – 91 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

Referenca dhe bibliografi : f. 90

1.Gajraku, Gani

ISBN 978-9951-591-27-0

ISBN 978-9951-591-27-0

